

VENDIM
Nr. 61, datë 2.11.2007

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR NDËRTIM, INSTALIM DHE SHFRYTËZIM TË
CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË, SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA KËTO CENTRALE “HERA” SHPK (PROJEKTI KAPPET)**

*(Ndryshuar me vendimin nr. 93, datë 6.8.2008; nr. 65, datë 22.9.2009; nr. 254, datë
21.12.2020; nr. 112¹, datë 26.4.2021)*

(i përditësuar)

Në zbatim të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” me ndryshimet përkatëse, neni 13, pika 1, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 4.4.2007 “Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit”, neni 11, pika 1, neni 13, pikat 1 dhe 2, vendimit nr. 44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 15, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 2.11.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “HERA” sh.p.k. për marrje licence për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centralit elektrik me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale,

VENDOSI:

I. Dhënie e licencës shoqërisë “HERA” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike (Projekti KAPPET), me fuqi 150 MGW, duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

1. Shoqëria “Hera” sh.p.k. të depozitojë në ERE, brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare e këtij vendimi, kontratat e rinovuara të qirasë, me bashkitë përkatëse, për të gjithë sipërfaqen e nevojshme për realizimin e projektit.

2. Shoqëria “HERA” sh.p.k. duhet të paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a.-në, përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.

3. Shoqëria “HERA” sh.p.k. do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Koha e zbatimit të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës të jetë 42 muaj.

5. Shoqëria “Hera” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE, brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare e këtij vendimi, lejen mjedisore të rinovuar.

II. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

¹Vendimi nr. 112, datë 26.4.2021 në pikën 4 shprehet;

“4. Shoqëria “Hera” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE, brenda 3 muajve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare e këtij vendimi:

a. dokumentacion mbi marrjen e miratimit të plotë nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve;

b. dokumentacion ligjor vërtetues mbi realizimin e investimeve për zbatimin e projektit eolik.”

